



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 486/23 Dt. 18.07.2023



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

Zyra e Kryetarit

DATË:	13.07.2023
PËR:	Zyrën Kombëtare të Auditimit
NGA:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
LENDË:	PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2022

Të nderuar,

Në pajtim me nenin 14, pika 1 deri në 7 të Rregullorës së punës për zbatimin e Auditimit dhe Planeve të veprimit të Zyres Kombëtare të Auditimit të aprovuar me datën 21.06.2019, ju lutem gjeni të bashkangjitur Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve nga Raporti Final i Auditimit për Komunën e Prizrenit për vitin financiar të përfunduar me 31.12.2022, të përgatitur nga anëtarët e grupit punues për përgatitjen e planit të veprimit dhe rishikimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në bashkëpunim me NjAB.

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE
TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2022**

Nr	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	Çështja B1 - Shpalosje jo e plotë e detyrimeve kontigjente në pasqyrat financiare	Detyrimet kontigjente nuk janë shpalosur në mënyrë të plotë dhe Gjithëpërfshirëse në pasqyrat financiare. Gjatë vitit 2022, komuna ka bërë një rishikim të listës por nuk ka arritë të ketë një evidencë të plotë të regjistrit të lëndëve kontestimore përgjatë viteve, duke regjistruar vetëm atotë vitit 2021 dhe 2022. Vlera e detyrimeve kontigjente e prezantuar në Pasqyrat financiare është 2,351,332€. Në aneksin e pasqyrave financiare, përveç rasteve kur është vlerësuar vlera e kontestit, janë shpalosur edhe 325 raste apo padi që i përkasin kategorisë së investimeve kapitale dhe pagave e mëditjeve, me vlerë zero apo pa ndonjë vlerë financiare të Kontestit. Nga tri mostra të testuara të prezantuara me vlerë zero, kemi Konstatuar se vlera e padive është 6,000€.	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë një koordinim të duhur të informacionit dhe përmirësim të komunikimit në mes departamenteve, në mënyrë që të sigurohen evidenca të sakta dhe të plota të detyrimeve kontigjente për prezantim në pasqyrat vjetore financiare.	Për çdo akt fillestar me të cilin inicohet procedura dhe në të cilat është përcaktuar vlera e padisë apo aktit tjetër do të regjistrohen me pranimin e tyre, si dhe të atyre që në fillim nuk e kanë të përcaktuar vlerën e kontestit, mirëpo me caktimin e ekspertizes do të rishikohen dhe do të vendoset vlera e detyrimeve kontigjente. Konsidetrojmë se një veprim i tillë do ta mundësojë që detyrimet kontigjente do të shpalosen në mënyrë më të plotë. Gjithashtu edhe detyrimet kontigjente para viteve të kaluara i kemi klasifikuar dhe llogaritur në shumë totale nga 2013-2020.	Përfaqësuesja Ligjore e Komunës	Deri më 31.12.2023

2	Çështja B2 - Regjistrim i shpenzimeve në kategori ekonomike joadekuat	Nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve janë paguar 100,000€ për rehabilitimin dhe ndërtimin e rrugëve me asfalt, që për nga natyra shpenzimi i takon investimeve kapitale; dhe • si rezultat i vendimeve gjyqësore / përmbartimore, pagesat direkte nga Thesari nga buxheti për investime kapitale ishin 44,267€ për pagesën e shujtave, e që për nga natyra i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve.	Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuatë të buxhetit (apo të ri-destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuatë.	Ne në vijim do të forcojmë kontrollin gjatë planifikimit të buxhetit dhe për çdo ndarje buxhetore do të planifikohet, shpenzohet, regjistrohet sipas kategorive ekonomike adekuatë. Bashkëpunimi në mes zyrtarëve të planifikimit të buxhetit në DBF dhe departamentit të planifikimit të buxhetit në MFPT, për të definuar paqartësi për kategoritë e renovimeve dhe rehabilitimet, se a duhet të planifikohen në MSH apo në IK. ZKF do të shtojë kontrollin në mbikqyrjen e pagesave që zyrtaret autorizues dhe ata zotues ti përdorin kodet ekonomike të përcaktuara në planin kontabël. Sa i përketë pagesave për shpenzime për shujta të punonjësve arsimor, të cilat ishin regjistruar në kategorinë ekonomike të Investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, këto pagesa janë ekzekutuar nga thesari (procedur përmbartimore) dhe janë marrë mjete nga kategoritë të cilat kanë pasur mjete të lira, kjo çështje duhet të ngritet në nivel të ministrive përkatëse se pse edhe pas kërkesave për planifikim për pagat jubilarë dhe shujta nuk lejohen limitet për planifikim buxhetor.	Programet buxhetore (Drejtoritë), ZKF, DBF	Gjatë vitit 2023 me rastin e përgatitjes dhe aprovimit të buxhetit komunal dhe ekzekutimit të pagesave. Sa i përket çështjes së shujtave, zbatimi i plotë i rekomandimit nuk do të mund të ndodhë brenda vitit 2023, por është proces i vazhdueshëm.
3	Çështja B3 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme nga taksat për mbeturina	Sipas regjistrimit analitik, llogaritë e arkëtueshme nga taksat për mbeturina ishin 4,4602,730€, ndërsa në pasqyrat financiare janë shpalosur në vlerën 4,635,271€, duke mbivlerësuar saldon e të arkëtueshmeve për 32,541.00€.	Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë përkatëse mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyra financiare të jetë i saktë dhe i drejtë.	Do të marrim masa në avansimin e programit për menaxhimin e mbeturinave në mënyrë që të dhënat të gjenerohen nga sistemi, me qëllim që vlera e të arkëtueshmeve të prezantohen drejt në Pasqyrat Vjetore Financiare.	Udhëheqësi i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit në Drejtorinë e Shërbimeve Publike	shtator – dhjetor 2023

4	Çështja A1 - Vonesë në realizim të projekteve kapitale dhe mangësi në sigurim dhe garancion të punimeve të realizuara	Vonesa në realizim të projekteve kapitale janë hasur te: • Projekti për Ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Zym, në vlerë 392,968€, e nënshkruar me datë 07.11.2019 dhe me plan dinamik të realizimit për 300 ditë pune, është përfunduar me vonesë prej 212 ditëve. Në raportin përfundimtar të përgatitur nga mbikëqyrësi i projektit nuk janë dhënë informacione apo arsyetime për vonesat nërealizim të projektit. Siguria e ekzekutimit të kontratës kishte skaduar më datë 08.02.2021, dhe nuk ishte kërkuar vazhdimi i saj. Gjithashtu, siguria e garancionit të punimeve ishte bërë vetëm për 1 vit, ndonëse me kontratë është kërkuar garancion prej 3 viteve nga data e pranimit teknik të punimeve. Pas shqyrtimit të lëndës gjatë punës audituese, OE ka siguruar sigurimin shtesë të garancionit të punimeve edhe për dy vite tjera. • Projekti për Ndërtimin e infrastrukturës në fshatin Malësi e Vrrinit, në vlerë 108,825€, e nënshkruar në fund të vitit 2021, dhe e planifikuar të realizohej për 150 ditë pune, nuk është përfunduar as deri në muajin prill 2023. Siguria e ekzekutimit të kontratës për këtë project ishte bërë për afatin 6 muaj apo deri 30.06.2022. Nga kjo kohë deri më 28.03.2023, kur kemi shqyrtuar/audituar lëndën, kontrata ishte pa mbulesë të sigurisë. Më pas është sjellë siguria e re e ekzekutimit përafatin 1 vjeçar.	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuar të aplikohen penalet e parapara me kontratë. Siguria e ekzekutimit të kontratës dhe garancioni i punimeve të bëhen në vlerën dhe afatin e përcaktuar me kushtet e veçanta të kontratës. Në rastet kur projektet tejkalojnë planin dinamik të realizimit, sigurimi i ekzekutimit të kontratës duhet të vazhdohet dhe të mbulojë periudhën kohore deri në realizim.	Këto dy të gjetura që janë adresuar kanë ndodhur për shkak të angazhimit maksimal të Menaxherëve të Kontratës (një menaxher Kontratës i ka mbi 30 kontrata aktive). Menaxhmenti i drejtorisë së Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Menaxherët e Kontratës dhe organet mbikqyrëse veç sa kanë filluar ta zbatojnë këtë rekomandim, ku në shumicën e projekteve janë të siguruar garancionet e punimeve, ndërsa për rastet në fjalë ka ndërrmarrë veprime të menjherëshme nga momenti i identifikimit të çështjes nga auditorët, OE kan siguruar sigurimin shtesë të garancionit të punimeve edhe për dy vite tjera.	Menaxherët e Kontratës në Drejtorin e Shërbimeve Publike, Udhëheqësi i Prokurimit.	Nga qershori vitit 2023 ka filluar së zbatuari dhe ky proces do të monitorohet në vazhdimësi gjatë vitit.
5	Çështja B4 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare	Katër pagesa për investime kapitale në vlerë 187,358€, dhe tri pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 41,380€, janë realizuar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturës. Vonesat ishin nga 1 deri 237 ditë.	Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet Buxhetore të jenë zotuar në paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.	Do të shtohet kontrolla që zyrtarët financiar/menaxherët e kontratave të zbatojnë kërkesat ligjore të përcaktuar në LMFPP dhe Rregullen Financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parasë publike, me theks të veçant që pagesat për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor, ndërsa në ato raste kur nuk ka mjete financiare për pagesë brenda afatit të raportohen si obligime financiare te ZKF.	Menaxherët e Kontratës, zyrtarët financiar të drejtorive, zyrtarët/e e thesarit, ZKF	gusht-dhjetor 2023

6	Çështja A2 - Mangësi në procedurat e prokurimit publik	Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, kemi identifikuar mangësitë të projektet si në vijim: • Ndërtimi i rrugës tranzitore - kryqëzimi me autostradën në Prizren, në vlerë 785,055€, një nga kriteret ishte që OE duhet të ketë një inxhinier të diplomuar të komunikacionit, me përvojë pune jo më pak se 3 vite. OE kishte sjellë vetëm diplomën e punonjësit por jo edhe dëshmitë për përvojën e punës. • Furnizim me pajisje stomatologjike për nevojat e departamentit të stomatologjisë në vlerë 25,750€, një nga kriteret e kërkuara në njoftimin për kontratë ishte ofrimi i katalogut nga prodhuesi me specifikimet teknike për pajisjet e ofruara. OE fitues kishte ofruar specifikacion teknik vetëm për njërin pajisje (printer), ndërsa për pajisjet tjera nuk kishte ofruar katalog me specifikacione teknike, por ka ofruar vetëm foto të pajisjes. Po ashtu, si kriter është kërkuar autorizimi nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për shitje dhe servisim të pajisjeve, ndërsa OE ka sjellë dy autorizime nga prodhuesi vetëm për shitje, por jo edhe për servisim të pajisjeve, dhe që Autorizimet nuk përmbanin emërtimet e llojit të pajisjeve që janë ofruar nga OE. • Renovimi i qendrës sportive Sezai Surroi në Prizren, në vlerë 518,036€, në paramasë / specifikacion teknik është përcaktuar marka tregtare apo lloji i pajisjeve. Në paralogari ishte caktuar lloji apo modeli i Termo Pompës Hisense, si dhe kaloriferëve të modelit Sonigiei. • Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara në komunën e Prizrenit, me vlerë të parashikuar 1,500,000€, me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë është kërkuar sigurimi i ekzekutimit në 10% të vlerës së parashikuar të kontratës në afat prej 37 muajve. Para nënshkrimit të kontratës, OE kishte sjellë sigurimin në vlerë 150,000€ në afat prej 12 muajve, e jo për 37 muaj. Pas skadimi të sigurimit, është bërë sigurimi i dytë në vlerë 59,797€ në afat 12 muaj, dhe pas skadimit të sigurimit të dytë është bërë sigurimi i tretë në vlerë 21,500€ në afat 12 muaj.	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Specifikimet teknike të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore, duke mos përdorur emrin e markës tregtare apo modelit që favorizon apo diskriminon ndonjë OE. Gjithashtu, të sigurohet se sigurimi i ekzekutimit të kontratës bëhet në vlerën dhe afatin e përcaktuar me njoftimin për kontratë.	Në secilin projekt i cili i nënshtrohet procesit të prokurimit, zyra e prokurimit ose e monitoron me një zyrtar nga ky departament ose e cakton një zyrtar si anëtarë të komisionit të vlerësimit. Menaxheri i prokurimit përmes procesit monitorues në vazhdimësi do të sigurojë se njesitë e kërkesës para inicimit të procesit të prokurimit, do të parashtrojnë kërkesat e tyre në harmoni me LPP dhe RrUOP, gjithashtu do të monitorojm procesin e vlerësimit të tenderëve dhe do të sigurojmë që komisionet e vlerësimit do të respektojnë të gjitha kërkesat e përcaktura në DT si dhe kërkesat tjera ligjore të përcaktuar në LPP dhe RrUOP.	Anëtarët e komisionit të vlerësimit, Udhëheqësi i Prokurimit.	Në vazhdimësi deri me 31.12.2023
---	--	--	--	---	--	---

7	Çështja A3 - Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratave publike	Në tre raste zotimet e mjeteve në SIMFK ishin bërë pas nënshkrimit të kontratave publike. Rastet kanë të bëjnë me projektet për: • Ndërtimin e qendrës së mjekësisë familjare në ambientet e ish KFOR-it në Prizren (projekt tre vjeçar), në vlerë 2,323,000€, e nënshkruar pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore në SIMFK. Zotimi i pjesshëm i mjeteve është bërë dy muaj pas nënshkrimit të kontratës, atëherë kur është paguar situacioni i parë i punimeve. Një pjesë e zotimi ishte bërë në vitin 2021 kur ishte inicuar procedura e prokurimit, derisa kontrata është nënshkruar me datë 27.05.2022. • Ndërtimin e infrastrukturës në fshatin Krushë e Vogël (projekt dy vjeçar), në vlerë 121,555€, e datës 02.02.2022, e nënshkruar pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore në SIMFK. Zotimi i pjesshëm i mjeteve është bërë gati 3 muaj pas nënshkrimit të kontratës, atëherë kur është paguar situacioni i parë i punimeve. • Dezinfectimi, dezinfektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe l zonave periferike, në vlerë të parashikuar 210,000€, ishte nënshkruar pa zotim paraprak të mjeteve financiare. Zotimi i pjesshëm për këtë kontratë ishte bërë një muaj pas datës së nënshkrimit. Kontrata është nënshkruar më datë 30.03.2022, ndërsa një pjesë e zotimit të mjeteve është bërë në vitin 2021, pasi si procedurë e prokurimit kishte filluar në vitin 2021	Rekomandimi A3 Kryetari të sigurojë se para nënshkrimit të kontratave publike mjetet financiare zotohen në SIMFK. Në rastet kur procedurat e prokurimit përsërye objektive nuk finalizohen në vitin fiskal kur është filluar procesi i kontraktimit, atëherë ri-zotimi i mjeteve në SIMFK të bëhet në vitin vazhdues.	Projektet shpallen duke u bazuar në deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve financiare (ku ka raste që mjetet të jenë të planifikuara brenda tri viteve), zotimi për investime kapitale të financuara nga grandit qeveritar do të zotohen sipas planit të shpenzimeve. Për projektet që realizohen nga të hyrat vetanake, zotimi do të bëhet sipas alokimit për këto projekte(ku zotimi për këto projekte nuk do të mund të jetë sipas vlerës së kontratave të nënshkruara)	Njësitë e kërkesës, ZKF, Udhëheqësi i Prokurimit.	Në vazhdimësi deri me 31.12.2023
---	---	--	--	---	--	---

8	Çështja A4 - Mangësi në proceset e subvencionimit	Komisionet e vlerësimit të kërkesave për subvencione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit nuk kanë aplikuar formularët zyrtar të vlerësimit të kërkesave, siç kërkohet me Rregulloren MF-Nr-04/2017. Kjo është hasur në pesë mostra të testuara, e të cilat ishin në vlerë të përgjithshme 54,550€. Gjithashtu, kryesuesi i komisionit të vlerësimit të kërkesave ishte caktuar monitorues i projekteve të financuara. Monitoruesi nuk kishte përgatitur ndonjë raport pune rreth projekteve të subvencionuara apo nëse ka realizuar ndonjë vizitë në mbikëqyrjen e projekteve; • Me thirrjen publike në fushën e sportit, lot 2, përveç kriterëve tjerë është kërkuar që ekipi i futbollit të ketë së paku 2 trajner të licencuar. Përfituesi i projektit Masovizimi i futbollit prizrenas, në vlerë 30,000€, kishte sjellë një konfirmim me shkrim për trajnerët, por emrat e listuar në konfirmim nuk figuronin në regjistrin e lëshuar nga Lidhja Rajonale e Futbollit - Prizren. Përfituesi i subvencionit nuk kishte sjellë dëshmitë/licencat e trajnerëve; • Te procedurat e subvencionimit të prodhuesve të qumështit, përveç kriterëve tjerë për aplikim, ishte kërkuar nga fermerët dëshmia për verifikimin e kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë-AUV. Përfituesi/fermeri kishte sjellë një dokument të nënshkruar dhe vulosur nga vet fermeri për numrin e kafshëve, e jo nga AUV; dhe • Në dy raste përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raporte narrative dhe financiare për projektet e financuara nga Komuna. Projekti i parë në vlerë 45,000€ i takon fushës së sportit për pjesëmarrje në garat kombëtare të basketbollit, dhe projekti i dytë në fushën e rinisë për promovimin e punës vullnetare në vlerë 4,000€.	Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit shqyrtojnë aplikacionet në përputhje me kriteret e përcaktuara me thirrjen publike, dhe se përdorin formularët zyrtar të procesit të subvencionimit të OJQ-ve siç përcaktohet me rregullore. Po ashtu, monitorues të realizimit të projekteve të subvencionuara të mos jenë anëtarët e komisionit të vlerësimit të kërkesave. Gjithashtu të sigurohet se, monitoruesit e projekteve të mbikëqyrin realizimin e projekteve të subvencionuara dhe se përfituesit dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar pas përfundimit të projekteve.	Gjatë vitit 2023, me rastin e ndarjes së subvencioneve do të ndërmarrim të gjitha veprimet për tërë ciklin e ndarjes së subvencioneve sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në rregulloren MF-nr-04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit për OJQ. Në thirrjen për subvencionim për vitin 2023 do të shtohet kontrolli dhe do kërkohet nga ana e anëtarëve të komisionit për vlerësim, respektimin e të gjitha kriterëve të përcaktuara në thirrjet për aplikim. Zyrtaret monitorues të caktuar për përcjelljen e ekzekutimit të projektit, do të kërkojnë nga përfituesit e Subvencioneve, dorëzimin e raporteve narrative dhe financiar sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke i argumentuar me dokumente mbështetëse për shpenzimet e prezentura për realizimin e projektit.	Anëtarët e Komisionit të vlerësimit në DKRS Anëtarët e Komisionit të vlerësimit në DB Zyrtarët e monitorimit të caktuar në Kontratat e lidhura në mes Komunës dhe përfituesve të subvencioneve	Në vazhdimësi deri me 31.12.2023 korrik- dhjetor 2023 korrik- dhjetor 2023
---	--	--	---	---	---	---

9	Çështja B5 - Kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore / përmbarimore	Si pasojë e pagesave nga vendimet gjyqësore/përmbarimore, Komuna e Prizrenit ka paguar në emër të kamatave dhe procedurave të përmbarimit vlerën prej 205,872€. Në total pagesat përfshirë borxhin kryesor dhe kamatat ishin 1,688,164€. Nga kjo shumë, për paga e mëditje ishin paguar 588,064€, për mallra e shërbime 206,254€, shpenzime komunale 76,773€, dhe për investime kapitale 817,073€.	Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore / përmbarimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.	Çdo drejtori do ti dorëzojë me kohë faturat, për ti proceduar për pagesë, me qëllim që të shmangen pagesat përmes vendimeve gjyqësore / përmbarimore. Në rastet kur kemi pranuar kërkesa për ekzekutim të pagesave nga ana e thesarit(MFPT) ne do ti ndërmarrim të gjitha veprimet kur ka mjete financiare në dispozicion, pagesat të ekzekutohen nga kategoria ekonomike që është krijuar shpenzimi.	Njësitë buxhetore dhe ZKF	Pjesa më e madhe e pagesave përmes vendimeve gjyqësore, janë për pagesa që rrjedhin nga marrëveshjet kolektive për sistemin e arsimit, konsiderojmë që kjo çështje mund të mos zbatohet në tërësi edhe këtë vit.
10	Çështja A5 - Ndërrimi i afatit të kontratës së punës, nga kohë e caktuar në kohë të pacaktuar	Të punësuarit me kontratë për kohë të caktuar në pozitën vozitës në QKMF, tre muaj para skadimit të kontratës i është bërë kontratë e re me afat të pacaktuar, pa u zhvilluar procedurë e re rekrutimit.	Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë që të punësuarit me kontratë për kohë të caktuar angazhohen vetëm për afatin e caktuar me kontratë. Në rastet kur vlerësohet nevoja për punonjës të rregulltë, të zhvillohet procedura e rekrutimit përmes konkursit publik.	Bazuar në ligjin nr.06/L114 për Zyrtarët Publik, veçse është duke u zbatuar në përpikmëri procedura e pranimit dhe rekrutimit të shërbyesve publik dhe stafit administrativ dhe mbështetës së QKMF-së, duke pasur parasysh që përgjegjësia për zhvillimin e procedurave të konkursit ka kaluar tek NJMBNJ të Komunës së Prizrenit.	Zyrtaret e personelit në Drejtorin e Shëndetësisë	Në vazhdimësi
11	Çështja A6 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese apo verifikimit të pronave	Komuna nuk ka arritë që brenda vitit të verifikojë së paku 20% të objekteve të regjistruara. Nga 58,380 prona të regjistruara, gjatë vitit 2022 ishin verifikuar vetëm 9,155 objekte, apo 16% e objekteve të përgjithshme	Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë së është arritur së paku 20% e verifikimit të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës.	Zyra e Tatimit në pronë, do të rrisë kontrollin në inspektimin e pronave sipas kërkesës ligjore prej 20%. ne pjesën e parë të vitit 202, kemi rekrutuar tre zyrtar të terrenit, që do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e inspektimeve të pronave të paluajtshme.	Menaxheri i Tatimit në Pronë, zyrtarët e terrenit	Në vazhdimësi 31.12.2023
12	Çështja A7 - Parregullsi në menaxhimin e kontratave publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të poentuar (peshuar)	Gjatë realizimit të tri kontratave publike me çmim të poentuar, nuk është ruajtur raporti ndërmjet sasisë apo përqindjes së realizuara të kategorisë, dhe peshës apo përqindjes së dhënë gjatë kontraktimit asaj kategorie. Rastet janë hasur te: • Kontrata publike për Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara në Komunën e Prizrenit, me vlerë totale të parashikuar 1,500,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në 5 kategori, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë C Shërbime me zhavor e peshuar 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës apo deri në 300,000€, ishin shpenzuar 1,186,159€ apo 79% e vlerës së kontratës, duke e humbur raportin ndërmjet sasisë së realizuara dhe peshës së dhënë gjatë	Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë se te kontratat publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të peshuar, raporti i peshimit apo përqindjes së përcaktuar për kategoritë të jetë i njëjtë edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.	Në të dy rastet ku gjetjet i përkasin Drejtorisë për Shërbime Publike, Menaxhmenti së bashku me Menaxherët e Kontratës ka analizuar me kujdes dhe se ka filluar ta zbatojë menjëherë rekomandimin e dhënë. Menaxherët e projekteve në bashkëpunim me organin mbikqyrës kanë shtuar kontrollin e brendshëm në pozicionet/kategoritë e paramasave. Këtë kontroll e kanë argumentuar në krijimin e ashtuaquajterve “qarçaf”(krijim i një data bazë të kategorive që janë shpenzuar dhe që kanë mbetur pa shpenzuar) të specifikimeve teknike. Mbi bazën e kësaj evidence do të respektohen kategoritë e pozicioneve me çmimin e peshuar në kontratë.	Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, Menaxherët e Kontratës/orga ni mbikëqyrës në Drejtorinë e shërbimeve publike dhe Udhëheqësi i Zyres së Prokurimit	Ka filluar të zbatohet ky rekomandim.

	kontraktimit. Kategoria C kishte çmimin më të lartë të peshuar në krahasim me kategoritë tjera; - Kontrata publike për Intervenimi dhe riparimi ne sinjalistiken e Komunës së Prizrenit, ngritja e vendprritjeve për autobusët urbano periferik dhe nëpër fshatrat e komunës së Prizrenit, me vlerë totale të parashikuar 250,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa ishte ndarë në 3 kategori, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë A Punët përgatitore e peshuar 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës ose 50,000€, deri në fund të vitit 2022 ishin shpenzuar 126,600€ apo 51% e vlerës së kontratës. Kjo kategori kishte çmimin për njësi më të lartë në krahasim me kategoritë tjera; dhe - Kontrata publike për Renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të Komunës së Prizrenit, në vlerë të parashikuar 550,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në katër kategori kryesore, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë B Furnizimi, punimi dhe monitimi, e peshuar 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës ose 110,000€, ishin shpenzuar 288,565€ apo 52% e vlerës së përgjithshme të kontratës, duke e humbur raportin ndërmjet sasisë së realizuara dhe peshës së dhënë gjatë kontraktimit. Kjo kategori kishte çmimin më të lartë të peshuar në krahasim me kategoritë tjera.		Menaxheri e Kontratës i caktuar për mbikëqyrjen e Kontrates publike Renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të Komunës së Prizrenit, në bashkëpunim me organin mbikqyrës në momentin e ngritjes së çështjes nga ana e auditoreve lidhur me tejkalimin e pozicionit për kategorinë B, ka ndërmarrë veprime të menjëherëshme për ndalimin e kryerjes së punëve që lidhen me këtë pozicion.	Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, Menaxherët e Kontratës/organi mbikqyrës në Drejtorinë e Administratës, si dhe Udhëheqësi i Zyres së Prokurimit	Janë marrë veprime të menjëherëshme për zbatimin e këtij rekomandimi.
--	---	--	--	--	--

13	Çështja C1 - Mos regjistrimin i pasurisë jo kapitale në sistemin e-pasuria	Komuna nuk ka përdorur programin e-pasuria për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jokapitale. Në mungesë të përdorimit të sistemit epasuria, komuna kishte përdor formatin excel për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jokapitale, në të cilin ishin evidentuar edhe mostrat e testuara	Rekomandimi C1 Kryetari të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për aplikimin e sistemit të e-pasuria për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Zyrtaret e pranimit të blerjeve në Drejtorin e Administrates, Arsimit dhe Shëndetësisë do të fillojnë regjistrimin e pasurisë jokapitale të pranuar gjatë vitit 2023 në sistemin e-pasurisa nga momenti i delegimit të përgjegjësive dhe pranimit të qasjeve për këtë sistem.	Zyrtaret e pranimit të mallrave përmes depos në Drejtorinë e Administrates, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Arsimit, Zyrtari i Pasurisë, Drejtori/sha e DBF, DA, DSH, DKA	Gjatë viti 2023
14	Çështja A8 - Rritje e saldoshë llogarive të arkëtueshme	Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë 18,936,616€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (57%), taksat nga mbeturinat (24%), taksat për bizneset (13%), shfrytëzimi i pronës publike (5%) dhe nga urbanizmi (1%). Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje, ku në krahasim me vitin paraprak, të arkëtueshmet janë rritur për 1,212,183€.	Rekomandimi A8 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmesndërmarrjes se veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri të Tatimit në Pronë do të zhvillohen masa përmbartimore për inkasim të borxhit nga tatimi në pronë, Zyrtaret përgjegjës për taksat për bizneset do të zbatojnë të gjitha hapat konkret të përcaktuara me legjislacionin përkatës për inaksimin e të hyrave të mbetura nga vitet e kaluara. Sa i përket llogarive të arkëtueshme në lidhje me shfrytëzimin e hapsirave publike, ish zyrtarja ligjore ka proceduar për procedur përmbartuese shumicen e të arkëtueshme.Të gjitha këto inicime përmbartuese gjenden për inicim të mëtejshme te zyra e përfaqësuesit ligjor. Janë disa raste që kanë ndodhur në periudhë shumë të hershme kohore dhe si të tilla janë fituar rastet në gjykata nga operatorët ekonomik dhe si të tilla duhet të freskohen nga regjistrat e të arkëtueshmeve të mbajtur nga zyrtaret e të hyrave në DBF.	Menaxheri i ZTP, Zyrtërit e të hyrave për taksa nga bizneset, përgjegjësit e menaxhimit të hyrave nga dhënia e pronave në shfrytëzim si dhe përgjegjësit e drejtorive tjera që realizojnë të hyra komunale, ZKF	Ky rekomandim nuk mund të zbatohet në tërësi brenda vitit 2023, por është proces i vazhdueshëm

Prizren, korrik 2023

Kryetari i Komunës

Shaqir Totaj

